



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:128518

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06839117

2024:143951

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren e vetme gjykuese Fitore Daci, me procesmbajtëse Egzona Livoreka, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.A, me vendbanim në fshatin “.....”, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.Nr.383/24, të datës 17.05.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, përfaqësuesit të të dëmtuarës Ekonomia Pyjore Shtime-Tafil Hasani, si dhe të akuzuarit XH.A, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 23.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.02.2025 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

XH.A, i lindur me datë 22.02.1981, nga i ati H. dhe e ëma T.. e gjinisë H., me vendbanim në fshatin “.....”, komuna Shtime, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal “.....”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 29.02.2024 rreth orës 06:50h, në vendin e quajtur “Balli i prronit të vjetave”, në pyllin në Rajonin Ekonomik Pyjorë Mollopolc, në paralelen 22, i pandehuri XH.Asë bashku me djalin e tij të miturin B. Ademaj, pa lejen e organit kompetent me qëllim të vjedhjes së trungjeve kanë prerë me sharrë motorike dhe sopat 42 (dyzet e dy) copë drunjëve të llojit ahu, me diametër 12-

23 cm me gjatësi prej 9m, me vëllim të përgjithshëm prej 2.4 m³ dhe duke i transportuar me kuaj, ku me këto veprime i kanë e shkaktuar dëm ekonomisë pyjorë në vlerë prej 367,2 euro.

Me këtë veprim në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 69 dhe 70, si dhe nenit 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 364, 365 dhe nenit 452 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 viti /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Ekonomia Pyjore Shtime të ja paguajë dëmin në vlerë prej 367.2 € (euro).

Konform nenit 92 paragrafi 1, të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme sëpata si mjet i kryerjes së veprës penale.

Konform nenit 452 paragrafi 4 i KPPRK-së, i akuzuari XH. Alirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve procedurale pasi që i njëjti ka gjendje shumë të rënduar ekonomike dhe këtë e dëshmon përmes kartës së ndihmës sociale me numër 34558.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj–Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP/II.Nr.383/24 të datës 17.05.2024, kundër të akuzuarit XH.A, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, vjedhje e pyllit nga neni 349 paragrafi 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 01.07.2024, ku i akuzuari në këtë shqyrtim ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza.

Gjykata caktoi seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.01.2025, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Besnik Nuredini, përfaqësuesi i të dëmtuarës ekonomia pyjore Shtime–Tafil Hasani, si dhe i akuzuari XH.A.

Gjyqtarja e vetme gjykuese e udhëzoi të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së. Pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 321 paragrafi 1, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë përsëri që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: konsiderojmë se pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit të sotëm gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veç e veç dhe të gjitha së bashku është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari XH.A ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze.

Se i akuzuari ditën kritike me qëllim të vjedhjes së trungjeve dhe me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm, më së miri u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarit M.M i cili sot në mënyrë të qartë dhe koncize, pa rënë në kundërshtim në asnjë mënyrë edhe me deklarin e tij në prokurori si dhe përpilimin e fletëparaqitjes ka dëshmuar se si në ditën kritike gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, përderisa kishte qenë së bashku me kolegun e tij H.H kishte vërejtur të akuzuarin në vendin e ngjarjes duke përgatitur drunjte, e të cilat i kishte prerë me motor sharrë së bashku me djalin e tij Besarin. Edhe pse dëshmitari kishte tentuar të bëjë një fotografi, por që me të vërejtur i akuzuari, i njëjti duke marrë motor sharrën me vete ishte larguar nga vendi i ngjarjes, vetëm e vetëm që të mos të takohej nga zyrtaret e pylltarisë.

Në vendin e ngjarjes dëshmitari kishte vërejtur dy kuaj të renditur njeri pas tjetrit e me drunjtë të përgatitur për tërheqje, drunjtë të njoma e posa kishte kontaktuar me djalin e tij dhe kishte tentuar për t'ja marre sëpatën e cila është përdorur për kryerjen e kësaj vepre penale edhe për shkak të rezistencës fal profesionalizimit të zyrtarit ka arritur të ja sekuestroj të njëjtën, ku gjatë matjes së drunjtëve dhe trungjeve të prera në mënyre të qartë ka sqaruar se i akuzuari së bashku me djalin e tij kishte prerë 42 drunjtë të llojit ahu me vëllim të përgjithshëm prej 2.4 metër kub. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitari H.H, i cili sot në këtë shqyrtim gjyqësor ka dëshmuar saktë, qartë se si ditën kritike e ka vërejtur të akuzuarin me motor në dorë, i cili kishte prerë drunjtë dhe posa ishte vërejtur nga ai, i akuzuari ishte larguar nga aty.

Se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale kjo u vërtetua edhe nga provat tjera materiale të cilat u shqyrtuan në këtë shqyrtim gjyqësor si nga: Fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr 16/24 e datës 01.03.2024 dhe Foto-dokumentacioni mbi vendi e ngjarjes si dhe konfiskimi i mjetit i cili ka shërbyer për kryerjen e veprës penale. Faktet më të rëndësishme e të cilat duhet të ja fal besimin e plotë gjykata janë: dëshmitë e dy dëshmitareve, po ashtu edhe provat tjera materiale, ndërsa sa i përket të akuzuarit i njëjti duke e parë dhe duke u ballafaquar me të gjitha provat e pakontestueshme dhe duke mos mundur të i shmangët përgjegjësisë penale, i njëjti nuk pati rrugë tjetër veçse shfrytëzoi të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje, duke dashur vetëm e vetëm të mos sqarohet asnjë rrethane lidhur me rastin edhe përkundër provave të pakontestueshëm të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor.

Andaj, mbi bazën e provave dhe dëshmimeve të ligjshme të elaboruara me lartë kërkojmë nga gjykata që të akuzuarin ta gjej dhe shpall fajtorë, për veprën penale e cila i ngarkohet dhe të njëjtit të i shqiptoj një sanksion penal me të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, ashtu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, e posaçërisht si rrethanë rënduese të merret parasysh shkalla e lartë e dashjes për kryerjen e veprës penale për faktin se i njëjti me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyre të kundërligjshëm, ka ndërmarre veprime të tilla dhe ka dëmtuar Agjencinë e Pylltarisë që është në ruajtjen e shtetit, po ashtu edhe një fakt tjetër mjaft i rëndësishëm për gjykatën është se i akuzuari është i njohur për organet e drejtësisë pasi që ka një numër të madhe të rasteve penale të paraqitur në prokurori dhe në gjykatë, disa prej tyre kanë përfunduar edhe me aktgjykim të formës së prerë. Ndërsa, në rastin konkret prokuroria nuk gjeti asnjë rrethanë lehtësuese ndaj të akuzuarit, andaj kërkojë nga gjykata që të bëjë sekuestrimin në mënyre të përhershëm edhe mjetin të cilin e ka përdorur për kryerjen e kësaj

vepre penale dhe te njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës ekonomia pyjore Shtime–Tafil Hasani, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se përkrahë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe diçka më tepër nuk ka se çka të shtoj.

I akuzuari XH.A në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nuk e konsideroj vetëm fajtorë, kam gjendje të rënduar ekonomike, jam shfrytëzues i asistencës sociale si dhe kam nënën në gjendje tejte të rëndë shëndetësore.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari XH.A, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, kurse në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.01.2025, ka zgjedhur të drejtën që të mbrohet në heshtje.

Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ka ngarkuar aktakuza, gjykata ka bërë paraqitjen provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 paragrafi 1 dhe 2, të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

- Dëshmia e dëshmitarit M.M;
- Dëshmia e dëshmitarit H.H

Nga provat materiale:

- Procesverbali për marrjen në pyetje dëshmitarit M.M në prokurori e datës 25.09.2023;
- Fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 16/24 e datës 01.03.2024
- Foto-dokumentacioni mbi vendi e ngjarjes.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7 dhe 360, të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal, profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Dëshmitë e dëshmitareve

Nga dëshmia e dëshmitarit M.M e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 23.01.2025 i cili ka deklaruar se i kujtohet që ka dhënë deklaratë në prokurori më datë 16.05.2024 dhe qëndron në tërësi pranë asaj deklarate, deklaroi se më datë 29.02.2024 në orët e mëngjesit së bashku me kolegun tim H... kemi pasur në kontroll rajon Mollopoc dhe Petrovë dhe gjatë kontrollës e kanë dëgjuar një zhurmë motorike dhe kanë vazhduar në drejtim të zhurmës motorike, deri tek vendi i ngjarjes, rreth orës 06:50 të mëngjesit kemi hasur në dëmtues XH.A, së bashku me djalin e tij B... dhe në momentin kur kemi hasur në vendin e ngjarjes ku këta kishin prerë dru të njoma ahu me sharre motorike, XH.A ka qene afërsisht 30 metra nga trungjet ku kishte qene duke i lidhur të njëjtit për ti zhaguar (tërhequr), në momentin që na ka parë neve i njëjti ka tentuar të ik nga vendi i ngjarjes.

Menjëherë kam tentuar që ta fotografoje XH për arsye se i njëjti filloi të ik nga vendi i ngjarjes, por nuk arrita ta fotografoj sepse i njëjti u largua duke e lenë djalin e tij Besarin së bashku me dy kuajt dhe drunjtë e prera në vendin e ngjarjes. Pasi XH. u largu unë kam fotografuar të gjithë vendin e ngjarjes dhe nga djali i tij kam marrë sëpatën të cilën e kishte me vete, në këtë moment është larguar edhe Besari i cili i kishte dy kuajt të ngarkuar me drunjtë por pa ju bindur urdhrave tona i njëjti u largua.

Tutje deklaroi se ai së bashku me kolegun e tij H. kanë filluar numërimin e cungjeve të prera si dhe matjen e drunjtëve, dhe kanë konstatuar se kanë qenë 42 cungje të prera me diametër 12, 14, 16, 18, 20 dhe 23. Drunjtë e prera siç e cekta me lartë i ka marrë Besari në shtëpi dhe i kanë shfrytëzuar. Deklaroi se sëpatën të cilën e ka marrë nga Besari e ka dorëzuar në pylltari.

Deklaroi se të akuzuarin XH.A e ka parë me sytë e tij ditën kritike në vendin e ngjarjes dhe të njëjtin e ka njohur edhe me herët si dëmtues i pyllit, por i njëjti është larguar me të arritur ne,

dhe shton faktin se XH që nga ajo ditë me asnjëherë nuk është takuar duke prerë drunjtë, pra tani më nuk është dëmtues i pyjeve.

Gjykata vlerësoi me kujdes deklarin e dëshmitarit M.M dhe vëren se e njëjta është reale, e besueshme dhe në harmoni me shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë dhe me përshkrimin e vendit të ngjarjes, pasi që ngjarjen e përshkruan në mënyrë kronologjike dhe tejet bindëse.

I njëjti e përshkroi ngjarjen në hollësi se si ka ardhur deri te takimi me të akuzuarin XH.A dhe djalin e tij, Besarin, dhe deklaratat e tij nuk kishte ndryshime apo kundërthënie me deklaratën e dhënë në prokurori dhe se nga kjo deklaratë është vërtetuar se i dëshmitari gjatë orarit të tij të punës është takuar me të akuzuarin XH.A, i cili ishte duke prerë dru dhe kur dëshmitari ka arritur në vendin e ngjarjes në momentin që XH e ka parë ka filluar të ik dhe i njëjti e ka pasur të pamundur të i bëjë fotografi, pasi që i akuzuari është larguar ai ka fotografuar vendin e ngjarjes ku shihen trungjet e prera dhe ka marrë sëpatën nga djali i të akuzuarit i cili pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes.

Nga dëshmia e dëshmitarit H.H e dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 23.01.2025 i cili ka deklaruar se: punon në Agjencinë Pyjor të Kosovës, kam më shumë se 4 vite përvojë pune, për detyrë e ka daljen në terren dhe vëzhgimin e pyjeve apo ruajtjen nga dëmtuesit, i kujtohet se më datë 29.02.2024 ka qenë në terren së bashku me kolegun e tij M.M me të cilin janë takuar rreth orës 6 të mëngjesit tek vendi i quajturë “tek shtëpia e Haxhi Jupës”. Shton faktin se me detyra të punës është i ngarkuar në rajonin ekonomik-pyjor Petrovë – Topillë, ndërsa kolegu i tij M.M është personi përgjegjës për rajonin Mollopolc – Devedak.

Pas takimit me kolegun M. kanë vazhduar rrugën së bashku ku gjatë rrugës kanë vërejtur disa shenja të kuajve të cilit ishin ngjitur përpjete, dhe në këtë moment kanë dëgjuar një zhurmë të motor sharrës duke prerë drunjtë, kanë vazhduar në atë drejtim dhe kur janë afruar afër vendit të ngjarjes, zhurma e motorit u ndal. Ata janë afruar dhe në atë vend kanë hasur në dëmtuesin XH.A se bashku me djalin e tij Besarin. Besari ishte me kali ngjyrë të kuqe, kurse XH.. ishte mbrapa tij me kali ngjyrë të bardhë, i kishin prerë drunjtë, i kishin përgatitur duke i tërhequr në vendin ku kishin për ti grumbulluar.

Tutje deklaroi se posa e ka parë XH... së bashku me djalin e tij ka filluar të bëjë fotografi, por e ka vërejtur djali i tij Besari i cili i ka thënë babit të tij XH... “bab, ik se Hasani”, deklaroi se në

fotot e mia vërehej shume turbullt XH.. dhe se ka qenë e pamundur të bëjë fotografi me të qarta të XH.A për arsye të terrenit dhe XH.A është larguar me shpejtësi të madhe nga vendi i ngjarjes. Deklaron se ka vazhduar në drejtim të XH.A 50-60 metra, por i njëjti është larguar. Pasi që XH.A u largua ai menjëherë është nisur në drejtim të kolegut të tij M.M për arsye se të nijetin e kishte lënë duke u marre me Besarin i cili nuk dëshironte të ja jepte sëpatën. Në këtë moment Besari u largu në drejtim të shtëpisë së bashku me kuajt të cilët ishin duke i tërhequr drunjte zhagas, ndërsa unë me M... kemi mbetur ne vend te ngjarjes, dhe kanë bërë matjen dhe numërimin e trungjeve të prera. M.... ka bere matjen, ndërsa unë i kam damkosur me çekan trungjet. Kuajt janë larguar njeri pas tjetrit. Shton se XH.A që nga dita kritike me asnjëherë nuk është hasur më duke prerë drunjë në rajonin tone, kjo ka qenë hera e fundit.

Gjykata vlerësoi me kujdes deklarinimin e dëshmitarit H.H dhe vëren se e njëjta është reale, e besueshme dhe në harmoni me shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë dhe me përshkrimin e vendit të ngjarjes, pasi që ngjarjen e përshkruan në mënyrë kronologjike dhe tejet bindëse.

I njëjti e përshkroi ngjarjen se si ka ardhur deri te takimi me të akuzuarin XH.A, ku ai së bashku me kolegun e tij M.M gjatë orarit të punës kanë vërejtur disa gjurmë kuajsh dhe kanë dëgjuar zhurmën e një motor sharre, të njëjtit kanë vazhduar në drejtim të zhurmës dhe me tu afruar kanë hasur në të akuzuarin XH.A, së bashku me djalin e tij Besarin, në momentin që i akuzuari i ka parë, djali i të akuzuarit i ka thënë të akuzuarit “bab, ik se H...”, kështu i akuzuari ka filluar të ik nga vendi i ngjarjes, i njëjti i ka shkuar nga pas por nuk ka mundur ta arrij. Pastaj është kthyer në vendin e ngjarjes ku ishte kolegu i tij M... dhe kanë filluar të bëjnë matjen e trungjeve të prera, ku kolegu i tij ka bërë matjen kurse ai damkosjen me çekan të trungjeve.

Përmes provës materiale procesverbali për marrjen në pyetje dëshmitarit M.M në prokurori e datës 25.09.2023 është vërtetuar se i akuzuari është hasur më datë 29.02.2024 në vendin e ngjarjes duke prerë drunjë, me të parë dëshmitaret i njëjti është larguar nga aty, dëshmitarët kanë qëndruar në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë fotografi të drunjëve të prera.

Përmes provës materiale fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër 16/24 e datës 01.03.2024 është vërtetuar se më datë 29.02.2024 në vendin e quajtur “Balli i prronit të vjetave” në rajonin ekonomik Mollopolc është hasur i akuzuari XH.A duke prerë dru e të cilat ishin duke ia ngarkuar kuajve për ti tërhequr zvarrë. Po ashtu përmes kësaj prove vërtetohet sasia e drunjëve të prerë si dhe vlera e dëmit që i akuzuari ia ka shkaktuar të dëmtuarës.

Përmes provës materiale foto-dokumentacioni mbi vendi e ngjarjes është vërtetuar se në vendin e ngjarjes janë gjetur drunjë të prerë dhe kuaj të cilëve iu ishin ngarkuar sasia e drunjëve të prerë për ti tërhequr zvarrë deri në shtëpinë e të akuzuarit.

Andaj bazuar në dëshminë e dëshmitarëve, si dhe provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat gjykata i çmojë si prova thelbësisht të mbështetshme me anë të së cilave është vërtetuar në mënyrë të plotë besueshmëria e tyre së me veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ai akuzohet.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Vlen të ceket fakti se i akuzuari ka shfrytëzuar të drejtën të mbrohet në heshtje dhe të mos deklarohet lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj gjykata ka bërë vlerësimin e gjitha deklarimeve të tija që nga seanca e shqyrtimit fillestar ku i njëjti nuk e ka konsideruar veten fajtor lidhur me këtë veprë penale me të cilën e ngarko aktakuza, por gjykata edhe po qe se i pandehuri shfrytëzon të drejtën e tij për të mbrojtur në heshtje gjithëherë me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Baza ligjore

Sipas nenit 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për t'u kryer kjo veprë penale parashihet:

Paragrafi 1. 1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. i cili rezulton në:

Nga kjo dispozitë ligjore, forma themelore e kësaj veprë penale ekziston kur kryesi i veprës penale (në rastin konkret kryesi), pret trungje në pyll dhe sasia e tyre tejkalon dy metra kub.

Sipas vlerësimit të gjykatës, në rastin konkret elementet e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, bazuar në deklaratimet e palëve, deklaratimet e dëshmitarëve, fotografive si dhe shkresave të tjera të lëndës, janë përmbushur dhe atë së pari për faktin se: i akuzuari është hasur duke prerë drunjë në pyll dhe me rastin e matjes së tyre sasia e drunjëve të prerë ka kaluar sasinë prej 2 metrave kub.

Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69, 70. Gjykata në këtë rast si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se i njëjti është i gjendjes tejet të dobët ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes së tij, kujdestar i vetëm i nënës së tije të moshuar, si dhe faktin që nga ky rast më nuk është hasur duke prerë drunjë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se i njëjti është person i njohur për organet e drejtësisë, është i gjykuar me vendime të formës së prerë dhe atë për vepra të ngjashme penale, Aktgjykimi P.nr.583/19 të datës 06.07.2020, Aktgjykimi P.nr.1101/19 të datës 21.12.2020, Aktgjykimi P.nr.1063/20 të datës 08.07.2021, Aktgjykimi 2021:072933 të datës 12.10.2021, andaj bazuar në këto gjykata të njëjtit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Ekonomia Pyjore Shtime, të ja paguajë dëmin në vlerë prej 367.2 € (euro).

Vendimi për lirimin e të pandehurit nga shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 paragrafi 4 i KPPRK-së

Vendimi për konfiskim është marrë konform nenit 92 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:143951, datë 12.02.2025

Zyrtare ligjore

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Egzona Livoreka

Fitore Krivanjeva-Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.